

PROJEKT-REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2022, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

- Miratimin e Planit të ri Strategjik të Këshillit për sistemin gjyqësor në Shqipëri për vitin 2022 – 2024.
- Miratimin e Planit të ri të Komunikimit për Gjykatat, të shoqëruar me një sërë aktesh me qëllim rritjen e transparencës.
- Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 16 anëtarë dhe hapjen e garës për 3 vendet e mbetura vakante, përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve/gjyqtarëve.
- Ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit nr.495, datë 21.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”.
- Vazhdimin e zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore duke realizuar shtimin e stafit administrativ dhe mbështetjen teknike në sistemin e menaxhimit të

çështjeve në gjykatat e apelit, standardizimin dhe përmirësimin e sistemit të llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë, përmes miratimit të rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor” si dhe verifikimin dhe pranimin në shërbim civil gjyqësor të 15 punonjësve nga të cilët 5 këshilltarë ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmës ligjorë në gjykatat e apeleve.

- Përcaktimin e numrit të kuotave në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023, plotësimin me 45 kandidatë për magistratë në profilin gjyqtar dhe 10 kandidatë në profilin këshilltarë dhe ndihmësligjorë, për të cilët u krye edhe verifikimi i kriterëve formale ligjore, pasurisë dhe figurës për 50 kandidatë.
- Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve duke depozituar pranë KPK-së 30 raporte të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 150 dosje gjyqësore për 30 subjekte të rivlerësimit kalimtar.
- Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve duke zhvilluar 5 procedimeve disiplinore.
- Punën në lidhje me forcimin e kapaciteteve të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe kontributin për krijimin e sistemit të ri modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.
- Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, trajtimin e 744 kërkesave duke caktuar 920 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe përfshirë në skemë delegimi 10 gjyqtarë dhe transferuar me pëlqim 9 të tjerë.
- Vazhdimin e vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke hartuar dhe miratuar 27 raporte vlerësimi, duke prioritetizuar kandidatët të cilët janë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e posaçme dhe gjykatat e apeleve, me qëllim funksionalizimin apo ruajtjen e funksionalitetit të tyre.
- Zhvillimin e 114 mbledhjeve plenare nga të cilat 45 mbledhje për caktim gjyqtarësh me qëllim plotësimin e trupës gjyqësore dhe miratimin e 562 vendimeve.
- Marrjen e masave për përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve (ICMIS) dhe (ARKIT), duke iu përgjigjur me mbështetje teknike 686 kërkesave të gjykatave nga i gjithë vendi.
- Përfundimin me sukses të migrimit të gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm realizuar në

kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore si dhe përcaktimin e rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short, marrjen e masave të nevojshme si dhe testimin i këtij mekanizmi për të mundur realizimin me sukses në praktikë.

- Trajtimin e 24 kërkesave në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.
- Përditësimin me informacion të faqes zyrtare të internetit me materialet dhe vendimmarrjet e Këshillit.
- Vijimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitete, takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërinë civile, etj..
- Zhvillimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ASPA-n, projektet e asistencës së huaj etj., të 13 punonjësve të institucionit, 103 punonjësve të gjykatave dhe 220 gjyqtarëve.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

1. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë.
2. Të vijojë me ritme të shpejta procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
3. Të ndjekë ecurinë dhe problematikat në implementimin e hartës së re gjyqësore dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë rreth tyre, brenda Dhjetorit 2023.
4. Të vijojë me hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor për planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, veprimtarinë dhe mirë-funksionimin e gjykatave, si dhe atyre për vlerësimin, promovimin dhe disiplinën e gjyqtarëve.
5. Të finalizojë paketën e akteve të nevojshme për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore në zbatim të reformës për nëpunësin civil gjyqësor.
6. Të ndërtojë një strategji konkrete për menaxhimin e çështjeve që presin të shqyrtohen (backlog) si dhe të bëjë të mundur standartizimin e normës orientuese për evadimin e çështjeve.
7. Të nxisë Gjykatën e Lartë për njehsimin e praktikave gjyqësore me qëllim vendosjen e standarteve të njëjta në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, parimit të proporcionalitetit, veçanërisht për zbatimin e masave të sigurimit personal, aplikimin e gjyqësorëve të posaçme dhe veprave penale të dhunës në familje.
8. Të thellojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për përcaktimin e kuotave për magjistratët e rinj dhe për trajnimin fillestar të tyre si dhe për trajnimin e gjyqtarëve në detyrë.
9. Të vijojë me prioritet vlerësimet etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e miratuar.

10. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje.
11. Të kontribuojë, nëpërmjet kërkesave të motivuara dhe të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për hartimin e planit vjetor të inspektimeve tematike, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” veçanërisht në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.
12. Të raportojë në Kuvend brenda Dhjetorit 2023, në lidhje me ecurinë e krijimit të sistemit të ri modern të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore.
13. Të kontribuojë në adresimin e problematikave të konstatuara në progresraportin e Bashkimit Europian të vitit 2022 lidhur me aktivitetin e Këshillit.

Miratuar në _____